OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRŽIŠTA KOSTT d.d
Nr. 543 Dt. 30/08/2012
PRISHTINË-A

# KOSTT

# Raport për tremujorin e dytë 2012

## (01.04.2012-30.06.2012)

| | Përgatiti | Kontrolloi | Aprovoi |
|---|---|---|---|
| Emri Mbiemri | Nebih Haziri | Fadil Ismajli | Kryesuesi i BD Ramadan Paçarada |
| Nënshkrimi | [signature] | [signature] | [signature] |
| Data | 28/08/2012 | | 28.08.2012 |

**Raport Tremujor për Bordin e Drejtorëve në KOSTT**
**Përiudha Prill – Qershor 2012**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | **Titulli i Dokumentit** | Raport Tremujor 2012 |
| 2 | **Dërguesi i dokumentit** | **Fadil Ismajli, Kryeshef Ekzekutiv** |
| 3 | **Përmbajtja e Raportit** | **Kapitulli 1:** Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet që janë bëre gjatë tremujorit të dytë të vitit 2012<br><br>**Kapitulli 2:** Shqyrtim i performancës afariste dhe financiare<br>2.1. Raport i realizimit të Indikatorëve Kyç të Performancës – operimi i sistemit dhe operimi i transmisionit<br>2.2. Raport i operimit të tregut<br>2.3. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTT<br>2.4. Çështjet rregullative<br>2.5. Shqyrtimi i performancës financiare<br>2.5.1. Pasqyrat financiare (Bilanci i Gjendjes dhe Pasqyra e Fitimit/Humbjes, Realizimi i projekteve kapitale nga BK gjatë tremujorit të dytë të vitit 2012) 2.5.2. Analiza e IKP-ve financiare<br><br>**Kapitulli 3 :** Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore<br><br>**Kapitulli 4:** Kontratat/Transakcionet e konsiderueshme gjatë tremujorit të dytë të vitit 2012 nga burimet e KOSTT<br><br>**Shtojcë 1:** Raporti për funkcionimin e qeverisjes korporative |
| 4 | **Data e Raportimit** | |

# Hyrje

Raporti tremujori Prill – Qershor 2012 përmban të gjitha elemente konform nënit 31.1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ku brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport për tremujorin e sapo përfunduar ("tremujori përkatës") i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Pas aprovimit të këtij Raporti nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, ky Raport do të dërgohet te Njësia për Politikat dhe Monitorim të NP-ve.

Raporti paraqet rezultate kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë tremujorit të dytë të këtij viti si dhe të aktiviteteve krahasuar me planin vjetor dhe shkallën e realizimit.

Në kapitujt e këtij Raporti, paraqiten të dhënat kryesore për strukturën organizative dhe ndryshimet e bëra, shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare, e shprehur edhe me Indikatorët Kyç të Performancës (IKP) teknike dhe financiare, të dhënat rreth operimit të tregut, projektet aktive në KOSTT të paraqitura sipas vlerës, afateve dhe statusit të tyre, procedurat gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruar, transakcionet e konsiderueshme të tremujorit të dytë, për të përfunduar me Shtojcën, e cila paraqet funkcionimin e qeverisjes korporative të KOSTT-it.

Përbërja e Raportit është identike me përbërjen e definuar në nënin 31.1 të Ligjit Nr. 03/L-087.

# 1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë tremujorit të dytë 2012

## 1.1. Organizimi

Struktura organizative e KOSTT-it është e përbërë nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti. KOSTT është përcaktuar të ketë një afarizëm të pavarur dhe si i tillë reflekton një fushëveprim bilateral të afarizmit.

Afarizmi i KOSTT zhvillohet nga 8 (tetë) Departamente, 3 (tri) Zyre të përbëra në strukturën e Drejtorisë Qendrore. Në strukturën e KOSTT janë të përfshirë edhe pozitat e Kryeshefit Ekzekutiv, 2 (dy) Zëvendës të KSHE, njeri me përgjegjësi për operim ndërsa tjetri për zhvillim, Sekretarit të Kompanisë, Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Trezorit, si dhe Zyrtarit për Auditimin e Brendshëm.

Organizimi i KOSTT është bazuar në afarizmin themelor tekniko-operativ, ku mbulohet me Departamentet:

- Operatori i Sistemit
- Operatori i Transmisionit
- Operatori i Tregut

Afarizmi tjetër ka karakter projektues, komercial, rregullativ, ligjor, marrëdhënieve me punëtorë, administrativ, zhvillimit të personelit, teknologjisë së informacionit dhe zhvillohet përmes Departamenteve mbështetëse:

- Inxhinieringu dhe Menaxhimi i Projekteve
- Çështjet Ligjore dhe Rregullative
- Financat
- Burimet Njerëzore dhe
- Prokurimit

Në Drejtorinë Qendrore të KOSTT-it janë edhe tri njësi, të emëruara si Zyre, të cilat kanë karakter mbështetës në aspektin e obligimeve financiare, ligjore dhe organizative, që janë:

- Zyra për Zhvillim dhe Planifikim Afatgjatë
- Zyra për Komunikim dhe Relacionë me Publikun dhe
- Zyra për Siguri Industriale dhe Mjedis

## 1.2. Numri i Punëtorëve

Me datën 31 Mars 2012 numri i përgjithshëm i punëtorëve ka qenë 239.

Me datën 1 Prill 2012 numri i punëtorëve në KOSTT ka arrit në 370, ndërsa më 30 Qershor 2012 numri i përgjithshëm i të punësuarve është 367.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur lëvizje të numrit të punëtorëve për këto arsye:

- Me 1 Prill 2012 në bazë të Vendimit të Qeverisë dhe Marrëveshjes së nënshkruar KOSTT-KEK, janë transferuar nga KEK në KOSTT 130 punëtorë
- 1 punëtore ka filluar punën në pozitën Specialist për mbrojtje të mjedisit
- 2 (dy) punëtorë janë pensionuar gjatë muajit prill dhe maj 2012
- 1 punëtores i është ndërprerë marrëdhënia e punës me kërkesën e saj

Nga numri i përgjithshëm i punëtorëve (367) , një (1) punëtorë gjendet në pushim pa pagesë

Në vazhdim është dhënë Organogrami – Makro Struktura organizative aktuale e KOSTT-it.


Bordi i Drejtoreve
Komisioni i Auditimit
Kryeshefi Ekzekutiv
Zyrtari i Auditimit të Brendshëm
Zëvendës i Kryeshefit Ekzekutiv për Operim
Zëvendës i Kryeshefit Ekzekutiv për Zhvillim
Zyra e Sigurisë dhe Mjedisit
Sekretari i Kompanisë
Zyra e Komunikimit dhe Relacione me Publikun
Zyra e Zhvillimit dhe Planifikimit Afatgjate
Operimi i Transmisonit
Operimi i Sistemit
Prokurimi
Financat dhe Thesari
Operimi i Tregut
Inxhinieringu dhe Menaxhimi i Projekteve
Çështjet Ligjore dhe Rregullative
Burimet Njerëzore

## 2.1. Raport për operimin e sistemit dhe transmisionit për Indikatorët Teknik të Performancës

### 2.1.1. Balanca e planifikuar dhe e realizuar për Prill- Qershor 2012

| Muajt | Prill-Qershor | | |
|---|---|---|---|
| MWh | E planifikuar | E realizuar | Real/Plan% |
| (1) TC Kosova A | 349 920 | 418 335 | 119,55 |
| (2) TC Kosova B | 804 418 | 815 844 | 101,42 |
| (3) Energjia për shpenzime vetanake (TC A+TC B) | 36 412 | 0 | 0,00 |
| (4) HC Ujmani | 18 000 | 19 397 | 107,76 |
| (5) HC Lumbardhi | 13 681 | 13 007 | 95,07 |
| (6)= 1+2+3+4 Prodhimi në prag të transmisionit | 1 208 750 | 1 253 576 | 103,71 |
| (7) Devijimi | 0 | 1 785 | 0,00 |
| (8) Eksporti | 104 063 | 167 055 | 160,53 |
| (9) Importi | 126 430 | 111 212 | 87,96 |
| (10) = 6-7-8+9 Energjia në disponim | 1 231 117 | 1 195 948 | 97,14 |
| (11) Distribucioni | 945 496 | 976 592 | 103,29 |
| (12) Ferronikeli | 163 800 | 79 632 | 48,62 |
| (13) Trepça | 5 697 | 5 471 | 96,04 |
| (14) Sharri | 19 100 | 16 786 | 87,89 |
| (15) Mihjet dhe konsum.jasht KEK | 32 100 | 30 855 | 96,12 |
| (16) Shpenzimet vetanake të TC nga transmisioni(LP290,B1,B2,T12,T34,T35,T45) | 36 412 | 64 702 | 177,69 |
| (17) = 11+12+13+14+15+16 Kërkesa neto | 1 202 605 | 1 174 038 | 97,62 |
| (18) Humbjet në transmission | 28 512 | 21 909 | 76,84 |
| (19) =17+18 Kërkesa gjithsej | 1 231 117 | 1 195 947 | 97,14 |

Të dhënat e planifikuara janë marrë nga dokumenti Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2012, ndërsa të dhënat e realizuara nga pikat matëse dhe të transferuara në kufi të Kosovës.

**Shpjegim:** (3) Energjia për shpenzime vetanake nga (TC A dhe TC B) e cila hyn në rrjetin e transmisionit është e barabartë me energjinë që termocentralet e marrin nga rrjeti i transmisionit për shpenzime vetanake (17). Rreshti (3) në tabelë në vlerat e realizuara është e përfshirë në pikën (6)-Prodhimi në prag të transmisionit.

Të dhënat në tabelë janë ilustruar edhe në diagramin vijues:



# Diagrami i balancës së realizuar elektroenergjetike Prill - Qershor 2012(GWh)



## 2.1.2. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit

| Nr | Indikatori | | Prill-Qershor 2011 | Prill-Qershor 2012 | 2012/2011(%) | Caku | Komenti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T1 | * Energjia që hyn në transmision (GWh) | | **1916,43** | **1868,30** | 97,49 | Nuk mund të vendoset sepse nuk mund të parashihet transiti, e me këte as hyrjet totale në transmision | Caku nuk vendoset për këtë IKP. |
| T2 | Piku koincident (MW) | | 875 | 932 | **106,51** | Caku: 1100MW (Sipas: Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2012). | Caku nuk vendoset për këtë IKP, por shihet që 6,51 % ka qenë piku më i lartë në periudhën Prill-Qershor 2012 se sa në periudhen e njëjtë të vitit 2011. |
| T3 | Gjatësia totale e linjave (km) | 400 kV | **181,815** | **188,49** | **103,67** | =>1 | Caku mund të vendoset për çdo vit me ndërtimin e linjave të reja ose riparimin/rindërtimin e linjave të cilat aktualisht nuk janë në operim. Ky cak bazohet në Planin Zhvillimor të Transmisionit. |
| | | 220 kV | **231,882** | **231,882** | **100,00** | | |
| | | 110 kV | **727,6** | **764,94** | **105,13** | | |
| T4 | MVA-km | 400 kV | **239450** | **248249** | **103,67** | =>1 | Caku është si në T3 |
| | | 220 kV | **77506** | **77506** | **100,00** | | |
| | | 110 kV | **80573** | **83209** | **103,27** | | |
| T5 | Kapaciteti i transformatorëve | 400-220;400-110 kV | **1500** | **1800** | **120,00** | =>1 | Ky cak mund të vendoset për çdo vit për instalimin e transformatorëve të ri. |
| | | 220-110 kV | **1200** | **1200** | **100,00** | | |
| T6 | Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar | | | | | | I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Import/Eksport(AATC) | | | | | | |
| T7 | Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal Import/Eksport MATC | | | | | | I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E |
| T8 | Pagesa për kongjestion | | | | | | KOSTT do të filloj kur ATC do të alokohet nga OT/kontrollohet nga OS për TTC teknike. |
| T9 | Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/vit) | | 44,55 | 64,84 | 145,53 | Caku vendoset sipas raportit: (AIT për periudhen actuale)/(AIT për periudhen e kaluar) < 1 | AIT (Koha mesatare e rënjes) 44,55 minuta gjatë tre muajve Prill-Qershor 2011, ndërsa 64,84 minuta për periudhen e njëjtë 2012. |
| T10 | Numri i ankesave për tension | | 1 | 1 | 100,00 | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | Caku për ankesa për tension duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave në vitin (et) paraprak në periudhen e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurtë. |
| T11 | Ankesat e zgjidhura për tension | Më pak se një javë | 1 | 1 | 100,00 | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | Caku për zgjidhjen e ankesave për tension duhet që në kohë sa më i shkurtër që të jetë e mundur(< 1 javë) të shqyrtohet ankesa. |
| | | Më pak se një muaj | | | | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | Caku për ankesa të matjeve duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave për vitin(et) paraprak(e). |
| | | Më shumë se një muaj | | | | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | |
| T12 | Numri i ankesave për matje | | 0 | 0 | | | |
| T13 | Ankesat e zgjidhura për matje | Më pak se një javë | 0 | 0 | | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | Caku për zgjidhjen e ankesave për matje duhet që në kohë sa më i shkurtër që të jetë e mundur(< 1 javë) |
| | | Më pak se | | | | Nr i përgjigjeve / Nr | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | një muaj | | | | ankesave =1 | të shqyrtohet ankesa. |
| | | Më shumë se një muaj | | | | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1 | |
| T14 | Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë) | Import | **20,48** | **28,15** | **137,45** | 20MWh/h tërheqje jashta programit të deklaruar | Stafi i Qendrës së Kontrollit ka për qëllim që devijimet mesatare absolute në orë të programeve të importeve/eksporteve të jenë sa më të vogla. |
| | | Eksport | **25,37** | **28,48** | **112,26** | 20MWh/h shtyerje jashta programit të deklaruar | |
| T15 | Humbjet në transmision (GWh) | | **23,94** | **21,91** | **91,53** | | Humbjet e energjisë elektrike në transmision kanë qenë për 8,47% më të vogla në periudhën Prill-Qershor 2012 se sa për periudhën e njëjtë 2011 |

AIT=(8760*60*ENS)/TE

ENS-Energy not supplied - EPF-Energjia e pafurnizuar

TE-Transmited energy - ET- Energjia e transmetuar (Energjia që hyn në transmision) është energjia e cila hyn në transmision nga prodhimi i gjeneratorëve (Prodhimi në prag të transmisionit) dhe importeve si rrjedha fizike nga linjat interkonektive (import flow).

AIT- Average interruption time - KMR - Koha mesatare e rënieve

## 2.1.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit

| Nr | Indikatori | Niveli i tensionit kV | 2011 Prill-Qershor | 2012 Prill-Qershor | Krahasimi 2012/2011 (%) | Caku <= 1 | Komenti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T1 | Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi | 400 | 0.00 | 0.00 | 0 | <= 1 | |
| | | 220 | 0.00 | 0.00 | 0 | | |
| | | 110 | 0.46 | 0.42 | 0.9 | | |
| T2 | Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë) | 400 | 0.00 | 0.00 | 0 | <= 1 | |
| | | 220 | 0.00 | 0.00 | 0 | | |
| | | 110 | 10.07 | 3.47 | 0.3 | | |
| T3 | Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta) | 400 | 0.00 | 0.00 | 0 | <= 1 | |
| | | 220 | 0.00 | 0.00 | 0 | | |
| | | 110 | 0.00 | 0.00 | 0 | | |
| T4 | Numri i prishjeve në transformator në 100 transformator(njësi) | 400/220(110) | 0.00 | 0.00 | 0 | <= 1 | |
| | | 220/110 | 0.10 | 0.00 | 0 | | |
| T5 | Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformator(orë) | 400/220(110) | 0.00 | 0.00 | 0 | <= 1 | |
| | | 220/110 | 3.00 | 0.00 | 0 | | |
| T6 | Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta) | 400/220(110) | 0.00 | 0.00 | 0 | <= 1 | |
| | | 220/110 | 0.00 | 0.00 | 0 | | |
| T7 | Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha | 400 | 0.00 | 0.00 | 0 | <= | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 220 | 0.00 | 0.00 | 0 | 1 | |
| | | 110 | 5.26 | 0.00 | 0 | | |
| T8 | Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë) | 400 | 0.00 | 0.00 | 0 | <= 1 | |
| | | 220 | 0.00 | 0.00 | 0 | | |
| | | 110 | 6.45 | 0.00 | 0 | | |
| T9 | Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta) | 400 | 0.00 | 0.00 | 0 | <= 1 | |
| | | 220 | 0.00 | 0.00 | 0 | | |
| | | 110 | 0.00 | 0.00 | 0 | | |
| T10 | Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha | 400 | 0.00 | 0.00 | 0 | <= 1 | |
| | | 220 | 0.00 | 0.00 | 0 | | |
| | | 110 | 0.00 | 0.00 | 0 | | |
| T11 | Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (orë) | 400 | 0.00 | 0.00 | 0 | <= 1 | |
| | | 220 | 0.00 | 0.00 | 0 | | |
| | | 110 | 0.00 | 0.00 | 0 | | |
| T12 | Koha mesatare shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta | 400 | 0.00 | 0.00 | 0 | <= 1 | |

## 2.2. Raport mbi operimin e tregut

### 2.2.1. Madhësia e Tregut

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral ku pjesa më e madhe e tregut është e rregulluar dhe mungon konkurrenca në tregun me shumicë dhe atë me pakicë. Ekziston vetëm një furnizues që furnizon konsumatorët e rregulluar dhe ata të pa rregulluar.

Të drejtën e konsumatorit të kualifikuar e shfrytëzon Feronikeli por meqenëse nuk ka furnizues tjerë të licencuar Feronikeli është furnizuar nga furnizuesi publik me kontratë me çmim të rregulluar. Për shkak te mungesës se komkurrencës dhe furnizuesve të tjerë dhe sipas ligjeve te reja lejohet që konsumatori i kualifikuar të furnizohet nga Furnizuesi Publik me çmim të rrgulluar i cili ndryshon nga niveli i tensionit ku ata janë të kyçur. Eshte arrite marveshje midis KEK , Feronikelit dhe ZRrE qe Feronikeli te furnizohet nga KEK me çmim te rregulluar në nivelin 220kV. Prandaj madhësia e tregut që i referohet segmentit të rregulluar në nivelin 220kV do të paraqitet në këtë tremujor si raport i energjisë së konsumuar nga konsumatorët e privilegjuar (kualifikuar) në raport me konsumin e përgjithshëm në Kosovë. Kjo përfshinë energjinë e përgjithshme që ka dalë nga transmisioni dhe energjinë që ka hyrë në distribucion nga Lumbardhi, e cila gjithashtu është pjesë e konsumit.

Deri më tani janë realizuar rreth 55.58% të të hyrave të lejuara të KOSTT por pritet që kjo përqindje të ndryshoj me aplikimin e tarifave të reja.

Si rezulatat i kushteve më të favorshme klimatike në këtë kuartal kemi rënje të humbjeve në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2011. TLF(Faktori i Humbjeve të Transmisionit) mesatare e realizuar në këtë tre-mujor është 1.0200, nga 1.0205 sa ishte në të njëjtën periudhë në 2011 .

Bilanci i rrjedhave të energjisë në rrjetin transmetues të KOSTT, si shihet mbi 25.90% të rrjedhave fizike të energjisë nëpër rrjetin transmetues janë tranzit i energjisë për nevoja regjionale, dhe për këtë shërbim KOSTT edhe më tutje nga mekanizmi i ITC nuk është duke u kompensuar por kompensohet EMS ( TSO e Serbisë).
Devijimet mujore sipas kompenzimit si dhe devijimet mujore të sistemit janë paraqitur në formë tabelare kurse krahasimi i tyre është paraqitur grafikisht.

Sipas estimimeve të KOSTT, energjia elektrike e reduktuar në këtë tre-mujor ështe mesatarisht rreth 0.41% e konsumit vendor, nga 5.95% sa ishte në periudhën e njëjtë në 2011.

Konsumi tarifor në nivelin me pakicë në këtë tremujor ishte mesatarisht rreth 85.23%.

Energjia që ka hyrë në rrjetin transmetues




Energjia që ka dalë nga rrjeti transmetues dhe humbjet në transmision







Pjesëmarrja e konsumit tarifor dhe jo tarifor

## 2.3. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTT

| Nr. | Emri i Projektit | Buxheti | Fincuar nga | Vlera e Kontrates | Data e fillimit | Data e kompletimit | Kontraktues | Realizimi: (i.) Progresi, (ii.) Rreziku dhe pengesat | Rekomandimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | *Paket Projekti Ferizaj-2 LOT-1: NS 400/110 kV Ferizaj 2* | 15,800,000.00 € | BK | 13,656,000.00 € | 24.12.2009 | 23.10.2012 | SIEMENS (At) | **(i.)** Projekti është në fazën e periudhës garantuese njëvjeçare. | |
| | *Paket Projekti Ferizaj-2 LOT-2:LP ndërlidhëse 400 & 110 kV* | 7,500,000.00 € | ECLO | 6,105,000.00 € | 31.12.2009 | 30.10.2011 | UMEL (B&H) | **(i.)** Projekti është në fazën e periudhes garantuese njëvjeçare. | |
| 2 | *Paket Projekti SCADA/EMS & Telekomi LOT-1: SCADA/EMS* | 8,500,000.00 € | BK | 7,875,370.00 € | 31.12.2008 | 30.06.2011 | Alstom/Komtel (F/RKS) | **(i.)** Sipas planit dinamik projekti është lëshuar në punë me 30.06.2011, por jo i kompletuar. Ka perfunduar Periudha e Disponueshmerise se Sistemit. Është nënshkruar dhe lëshuar Certificata e Pranimit Parcial të Përkohshëm (PPAC), më 04.11.2011, me ç'rast fillon edhe periudha garantuese njevjeçare, për ato pjesë të projektit. Gjatë kuartalit të dyë Q2, kompania kontraktuese ka punuar në eliminimin e vërejtjeve, si dhe në NS Prizreni 2 ka bërë testimin e 5 fushave të linjës dhe inkoorporimin në SCADA lokale (SCS). | Të gjitha vërejtjet e paraqitura gjatë SAT -testimeve dhe vërejtjet që janë paraqitur nga komisioni për pranim teknik intern, duhet të eliminohen brenda afatit të paraparë. |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ***Paket Projekti SCADA/EMS & Telekomi*** <br>***<u>LOT-2</u>: Telekomi*** | 9,500,000.00 € | BK | 9,214,760.00 € | 31.12.2008 | 30.06.2011 | Enegroinvest/Alstom(B&H/F) | **(i.)** Sipas planit dinamik projekti është pjesërisht i përfunduar dhe me 30.06.2011 dhe për sistemin SCADA/EMS & Telekomi është nënshkruar deklarata për kompletimin e projektit nga ana e ALSTOM&KOMTEL për përfundimin e punimeve të projektit. Ka përfunduar Periudha e Disponueshmërisë së Sistemit. Certifikata e Pranimit të Përkoshëm (parciale) PPAC lëshohet për pjesët e përfunduara, me ç'rast fillon edhe periudha garantuese njëvjeçare, për ato pjesë të projektit. Gjatë kuartalit të dytë Q2 kompania kontraktuese ka punuar në drejtim të eliminimit të vërejtjeve dhe ka realizuar integrimin e NS Vallaq në rrjetin e telekomunikimit. | Të gjitha vërejtjet e paraqitura gjatë SAT -testimeve dhe vërejtjet që do të paraqiten nga komisioni intern duhet të eliminohen brenda afatit garantues. |
| 3 | ***Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 & Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1)*** | 10.000.000,00 | ECLO | 6,308,920.00 € | 10.01.2011 | 09.07.2012 | KONCAR (Hr) | **(i)** Gjatë Q2 , kontraktuesi Konçar ka zhvilluar punët ndërtuese dhe instaluese sipas planit dinamik të punëve. Aktivitetet në terren janë zhvilluar në ndërtimin e bazamenteve , shtrirjen e kabllove, instalimin e pajisjeve në fushat e linjave anën 220 kV, është kryer betonimi i fushave të linjës dhe fushave transformatorike. Janë testuar dhe pranuar pajisjet e mbrojtjes rele, ormanat e matjeve si dhe ormani me bay control unit në fabrikë dhe janë liferuar në NS Prizreni 2, është liferuar dhe instaluar dhe testuar transformatori TR3 pritet energjizimi.<br>**(ii.)** Projekti ka pasë vonesa të arsyeshme për shkak të interfeisave në mes të dy projketeve me kontraktorë të ndryshëm dhe në takimin e mbajtur KOSTT /ECLO/Kontraktori dhe kompania konsulente Ingedia, është aprovuar arsyeshmëria e vonësës së implementimit të projektit dhe data e përfundimit të projektit është 01.10.2012 | |
| 4 | ***Ndërrimi i përçuesit, izolatorëve dhe pajisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3*** | 2,389,000.00 € | KOSTT | 1.959.800.80€ | 01.06.2011 | 20.12.2011 | ELSA&UKAB (Sl/RKS) | **(i).** Është vazhduar me demontimin e shtyllave të vjetra, mirëpo pasi që ende nuk kemi marr pëlqimin (lejen) nga Ministria e Ambientit dhe e Mjedisit, kemi kërkuar nga kontraktuesi që të ndalet me implementimin e projektit. Duhet theksuar se kontraktuesi ende nuk e ka sjellë dizajnin/projektin për linjën 110 kV Trepç-Vallaq, konfrom Ligjit për Ndërtim dhe Elaboratin e Shpronësimit, konform Ligjit për Shpronësime.<br>**(ii.)** Kontraktori ka sjellë dizajnet, të cilat janë dërguar në MPH për marrjen e lejeve, por njëkohësisht janë paraqitur edhe | Dizajnet – projektet e aprovuara dhe të kompletuara edhe për linjën 110kV Trpca – Vallaq ,duhet të dorzohen në Ministri pë marrjen e lejeve për ndërtim , konform kërkesave qe parashef Ligji për Ndërtim dhe Ligjit mbi Shpronësimet. |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | probleme me shpronësimin e tokave për ndërtimin e shyllave të reja. Janë mbajtur takime me strukturat komunale, por nuk ka rezultate. Projekti ka vonesa në implementim. | |
| 5 | *Kycja e NS Lipjanit në linjën LP 212 (Kosova A - Ferizaj 2)* | 1,050,000.00 € | KOSTT | 1,397,094.32 € | 27.06.2011 | 27.07.2012 | UMEL (B&H) | **(i).**Gjatë kuartalit të dytë , pas aprovimit të dizajnit në bashkëpunim me strukturat qeveritare, komunale projekti është shpall me interes të përgjithshëm dhe është marrë leja urbanistike, pritet marrja e lejës për ndërtim të LP 110kV që del nga NS Lipjani -110/35 kV.<br>(ii). Projekti ka vonesa në implementim, për shkak të performancës jo të mirë të kontraktuesit dhe procedurave në sigurimin e lejeve urbanistike dhe ndërtimore. | Dizajnet – projektet e aprovuara duhet të dorzohen në Ministri pë marrjen e lejeve për ndërtim , konform kërkesave qe parashef Ligji për Ndërtim dhe Ligjit mbi Shpronësimet. |
| 6 | *Ndërrimi i Mbrojtjeve Rele në NS 110/35kV Prishtina 2 dhe Prishtina 3* | 250,000.00 € | KOSTT | 168,880.32 € | 11.07.2011 | 02.01.2012 | KONCAR-KET (Hr) | **(i).** Projekti është kompletuar dhe është bërë Pranimi Teknik Intern. Projekti është në fazën garantuese njëvjeçare. | |
| 7 | ***Rehabilitimi në linjat 110kV, 126/4 (pjesa e vjetër), 179/1, 1801 (ndërrimi i izolatorëve dhe urave përçuese)*** | 150,000.00 € | KOSTT | 51,976.60 € | 25.09.2011 | 17.12.2011 | ELEGANCA (RKS) | **(i)** Pas krijimit të kushteve për shkyçje, është realizuar kompletimi i projektit .Kanë përfunduar punët implementuese në Linjën 110kV, nr.1801, në linjen 179/1 dhe në linjën 126/4<br>**(ii.)** Planifikohet komisionimi i punëve nga komisioni intern i KOSTT-it. Ka vonesa në projekt si pasojë e pamundësisë së krijimit të kushteve për punë - shkyçjet e linjave. | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | *Ndarja e zbarrave në dy seksione ne NS Gjilani 1 dhe NS Therande* | 150,000.00 € | KOSTT | 36,951.57 € | 09.08.2011 | 27.01.2012 | Ukab (RKS) | **(i)** Kontraktuesi ka filluar me implementimin e projektit dhe deri me tani ka ndërtuar bazamentin dhe ka instaluar ndarësin në (NS Theranda), mirëpo ende nuk është lëshuar në funksion, sepse duhet bërë ndërrimi i kahjes së hapjes së një ndarësi tjetër ekzistues në mënyrë që të mos ketë pengesa për hapjen e ndarësit të ri të instaluar. Ndërrimi i kahjes së hapjes së ndarësit do të bëhet pas marrjës së pëlqimit për shkyçje nga qendra nacionale dispeçerike. Në NS Gjilani 1 është caktuar lokacioni ku do të vendoset ndarësi mirëpo më parë duhet të bëhet zhvendosja e transformatorëve matës të tensionit (TMT-ve). | |
| 9 | *Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806 NS Gjakova 1 -Gjakova 2 dhe Rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1* | 1,500,000.00 € | KOSTT | 3,267,253.00 € | 02.12.2011 | 29.06.2012 (120 ditë pune) | Ukab (RKS)/ELSA (Si) | **(i)** Gjatë Q2 janë aprovuar dizajnet bazë dhe dokumentacioni është dërguar për aplikim në MPH për Leje Urbanistike . Është realizuar FAT (Pranimi Teknik në Fabrikë) për pajijset<br>**(ii).** Projekti ka vonesa të konsiderueshme, të shkaktuara nga ana e kontraktuesit, si pasojë e mosperformancës sipas kushteve të kontratës dhe procedurave në sigurimin e lejeve urbanistike dhe ndërtimore. Projektit pritet të përfundojë deri në fund të Dhjetorit 2012. | Konform Ligjit për Ndërtim dhe Ligjit mbi Shpronësimet në bashkëpunim me organet qeveritare dhe ato komunale projekti të shpallet me interes të përgjithshëm dhe të aplikohet për leje për ndërtim. |
| 10 | *Rehabilitimi i pajisjeve për shpenzime vetjake në NS 400/220kV - Kosova B* | 250,000.00 € | KOSTT | 272,409.00 € | 12.12.2011 | 20.07.2012 (150 ditë pune) | Monting (RKS) | **(i)** Kontraktuesi ka bërë një kërkesë për punët shtesë në lidhje me ndryshimet që do të bëhen gjatë implementimit të projektit. Kërkesa e kontraktuesit është aprovuar dhe punët po zhvillohen sipas planit dinamik të rifreskuar. Kontraktuesi ka kryer 60% të punëve demontuese dhe montuese të furnizimeve AC/DC në NS Kosova B, sipas dizajnit të aprovuar.<br>**(ii)** Për shkak të pamundësisë për krijimin e kushteve për punë (shkyçjet) projekti ka vonesa. Nëse krijohen kushtet për shkyçje sipas planit, projekti duhet të përfundojë në fund të shtatorit 2012. | |
| 11 | *Rehabilitimi i pajisjeve të tenisonit te larte (TL) 110kV në NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaji 1* | 1,150,000.00 € | KOSTT | 960,031.00 € | 18.02.2012 | 17.12.2012 | Enbi-Power (Al) | **(i)** Projekti është në fazën e implementimit. Pas komentimit / aprovimit të dizajnit kontraktuesi ka dorëzuar dizajnin për revidim. | Pas revidimit te dizajnit – projektit , conform kërkesave që dalin nga Ligji për Ndërtim do të aplikohet në ministri për leje për rehabilitimin e nënstacioneve . |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | *Instalimi i dy fushave te reja te linjave 110kV ne NS Prizreni 2* | 600,000.00 € | KOSTT | 551,998.00 € | 17.02.2012 | 03.08.2012 | Ukab (RKS) | (i) Projekti është në fazën e aprovimit të dizajnit bazik, janë aprovuar Time schedule, është sjell layout diagrami dhe single line diagrami me përmirësime nga vërejtëjet e bëra të cilat janë aprovuar, por ende nuk është aprovuar dizajni bazik dhe është në proces.Me datë 30.05.2012 është mbajt mbledhja mujore dhe është zhvilluar një vizitë në teren.Gjatë muajit qershor janë mbajtur disa takime në lidhje me disa pika të pakjarta që kanë pas lidhje me projekte tjera. Projekti bazik është aprovuar dhe i është lëshuar kontraktorit " Site Hand Over Certificate".Gjatë kësaj kohe kemi pas vizitë në terren për zhvendosjen e PTL të cilat kanë qenë të vendosura në vende të papërshtatme.Me datë 29.06.2012 është mbajt mbledhja mujore.Gjithashtu i kemi verifiku parametrat e TMT-ve dhe TMRr-ve ku parametrat e TMRr-ve kanë qenë sipas ofertës ndërsa ato të TMT-ve nuk kanë qenë sipas ofertës. | Është kërkuar nga kontraktuesi që dokumentacioni i kërkuar të jetë plotësisht sipas kërkesave të kontrates dhe specifikimit teknik . |
| 13 | *Rehabilitimi i stabilimenteve te TL ne NS Gjakova 2* | 1,400,000.00 € | KOSTT | | | | | (i). ToR dhe Specifikimi Teknik për projekt kanë përfunduar dhe është dorëzuar ne Departamentin e Prokurimit për procesin e tenderimit. | Nevojitet buxhet shtesë prej 700.000 EUR në vlerë totale tër projektit 2.100.000 EUR, që do të paraqitet në planin e biznesit dhe buxhetit të reviduar (rishikimi i buxhetit 2012). |
| 14 | *Rehabilitimi i stabilimenteve te TL ne NS Prizreni 3* | 1,400,000.00 € | KOSTT | | | | | (i). ToR dhe Specifikimi Teknik për projekt kanë përfunduar dhe është dorëzuar ne Departamentin e Prokurimit për procesin e tenderimit. | Nevojitet buxhet shtesë prej 700.000 EUR në vlerë totale tër projektit 2.100.000 EUR, që do të paraqitet në planin e biznesit dhe buxhetit të reviduar (rishikimi i buxhetit 2012). |
| 15 | *Furnizimi me softuerin E-Plan* | 50,000.00 € | KOSTT | | | | | (i). Termat e References dhe Specifikimet Teknike janë përgatitur me kohë dhe janë dorëzuar në Departamentin e Prokurimit me 23.01.2012, për procesin e tenderimit. | Nevojitet buxhet shtesë prej 30.000 EUR në vlerë totale të projektit 50.000 EUR, që do të paraqitet në planin e biznesit dhe buxhetit të reviduar (rishikimi i buxhetit 2012). |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 16 | *Asfaltimi i rruges se çasjes per ne NS 400/110 kV - Peja 3* | 150,000.00 € | KOSTT | 167,924.40 € | 13.06.2012 | 15.09.2012 (58 ditë pune) | Lika Trade (RKS) | **(i).** Termat e References dhe Specifikimet Teknike janë përgatitur me kohë dhe jane dorëzuar ne Departamentin e Prokurimit dhe është nënshkruar kontrata me 13.06.2012 me kompaninë "LIKA Trade". | |
| 17 | *Ndertimi i rrethojes se re ne NS 400/220 kV - Kosova B & Instalimi i ndriçimit pergjate saj* | 180,000.00 € | KOSTT | | | | | **(i).** Termat e References dhe Specifikimet Teknike janë përgatitur me kohë dhe jane dorëzuar në Departamentin e Prokurimit | |
| 18 | *Instalimi i kamerave vezhguese (CCTV) ne NS Kosova B dhe Depo* | 100,000.00 € | KOSTT | | | | | **(i).** Gjatë kuartalit të dytë është përgaditur Specifikimi Teknik dhe ToR për projekt dhe është dërguar në Departamentin e Prokurimit për procesin e tenderimit. | |
| 19 | *Instalimi i grupeve matëse sipas kufirit të rinj KOSTT/KEK (OSSH)* | I pa zotuar | KOSTT | | | | | **(i)** Me vendimin e ri të qeverisë të marrur në fund të Marsit 2012 mbi ndërrimin e kufirit komercial KOSTT/KEK OSSH dhe bazuar në Marreveshtje KOSTT/ KEK, KOSTT obligohet që në afat sa më të shkurtër të realizojë projektin për instalimin e grupeve të reja matëse (ndërrimin e TMRr dhe TMT, instalimn e njehsorëve matës) sipas Kodit të Matjes. Projekti është në fazën e përgatitjes së Termave të Referencës dhe Specifkimeve Teknike për këtë projekt. | Marrëveshtja e nënshkruar KOSTT /KEK mbi nërrimin e kufirt komercial me KEK /OSSH na obligon realizimin e projektit prandaj duhet zotuar |

**Progresi i Projektit të Linjës së interkonjeksionit 400 kV Kosovë – Shqipëri**

Aktivitetet në këtë Projekt janë zhvilluar lidhur me debllokimin e procesit të mbetur pezull dhe mundësisë së ritenderimit. Janë mbajtur takimet me zyrtarët e KfW, OST dhe Ministrin z. Haxhinasto, me kërkesën e tij.

Sipas vlerësimeve aktuale, tenderi do të kancellohet për Lot 1 ndërsa Lot 2 duhet të firmoset.

**Dokumentet mbështetëse që i referohen kancellimit dhe ritenderimit**

- Aktivitetet që duhet zhvilluar në procesin e zbatimit të kancellimit të Projektit të linjës 400 kV
- Letra e KfW mbi marrëveshtjet në mes të OST dhe KOSTT që i referohen kancellimit
- Letra e KfW lidhur me konkludimin e kontratës për Lot 2
- Deklarata e firmosur në mes të OST dhe KOSTT, e kërkuar nga KfW
- Draft Deklarata për mënyrën e mbulimit të shpenzimeve shtesë eventuale që mund të dalin nga procesi i ritenderimit
- Drafti i Aneksit të implementimit të linjës 400 kV Kosov-ë Shqipëri

**Plani për periudhën e ardhshme**

- Pritja për kancellimin e tenderit për Lot 1 (Linja 400 kV Kosovë –Shqipëri)
- Negocimi i kontratës për Lot2
- Negocimi eventual i kontratës për Linjën 400 kV Kosova B – Kufiri Qafë Morinë (pjesa e Kosovës)

## 2.4. Çështjet rregullative

Në fillim të muajit janar KOSTT ka pranuar nga ZRRE njoftimin për planet e ZRrE lidhur me procesin e shqyrtimit të tarifave të energjisë elektrike(SHTE6) të cilat pritet të hyjnë në fuqi nga data 1 prill 2012. Në tremujorin e parë KOSTT ka përgatitur aplikacionin për SHTE6, ka marrë pjesë në takimet dhe konsultimet e mbajturash ka paraqitur komentet ndaj Raportit Kosultativ

Me 2 Prill 2012, me ftesë të ZRrE-së, është mbajtur takimi ZRrE-KOSTT në lidhje me transferin e aseteve nga KEK në KOSTT. Qëllimi i takimit ishte sqarimi dhe definimi i shpenzimeve të cilat duhet të përfshihen në të Hyrat Maksimale të Lejuara për shkak të këtij transferi. Minutat e takimit janë dërguar në ZRrE me datë 5 Prill.

Me 5 Prill 2012, është dërguar në Zyrën e Rregullatorit për Energji dokumenti në të cilin KOSTT ka paraqitur kërkesën për bartjen e shpenzimeve në lidhje me asetet 110 kV të cilat transferohen në KOSTT sipas Marrëveshjes për Transferimin e aseteve nga KEK në KOSTT.

Me 21 Qershor 2012, ZRrE ka dërguar përgjigjet lidhur me komentet e KOSTT, si dhe propozimet për të Hyrat Maksimale të Lejuara.

Me 22 Qershor 2012, ZRrE ka dërguar Modelin Tarifor të përdorur për llogaritjen e MAR-it për Gjeneratorët e Rregulluar, KOSTT-in dhe OSSH-në si dhe tarifat e rregulluara me pakicë të FPEE-së.

Me 25 Qershor 2012, është pranuar Vendimi V_407_2012 me të cilin ZRrE ka miratuar Të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) që do të mbulohen nga tarifat dhe ngarkesat e rregulluara që do të aplikohen nga OST dhe OT për vitin relevant tarifor nga 01 Prill 2012 deri me 31 Mars 2013.

### Shqyrtimi i shtatë i tarifave (shumë-vjeçare) të energjisë elektrike (SHTE7)

Me 8 Qershor 2012, ka filluar Shqyrtimi i shtatë i tarifave (shumë-vjeçare) të energjisë elektrike (SHTE7), përmes dokumentit që përfshin edhe orarin indikativ.

Me 11 Qershor 2012, ZRrE ka dërguar Raportin Konsultativ për inicimin e SHTE7, dhe Formularet Raportues.

Me 26 Qershor 2012, KOSTT ka dërguar në ZRrE komentet dhe sygjerimet lidhur me Formularët Raportues dhe Raportin Konsultativ për SHTE7.

### Parimet për llogaritjen e ngarkesave DUOS dhe TUOS

Me 7 Qershor 2012, KOSTT ka pranuar nga ZRrE dokumentin për komentim: **Parimet për llogaritjen e ngarkesave DUOS dhe TUOS.**

Me 20 Qershor 2012, KOSTT ka dërguar në ZRrE komentet në lidhje me **Parimet për llogaritjen e ngarkesave DUOS dhe TUOS**.

**Modeli për Planifikim Afatgjatë Financiar**

Me 14 Maj 2012, është nënshkruar Kontrata për projektin: **Modeli për Planifikim Afatgjatë Financiar** dhe protokolluar me numër identifikues KOSTT 5519/1-12-79/11-221 Ofruesi i Shërbimeve është KPMG Bulgaria OOD dhe KPMG Albania Sh.p.k.- Dega në Kosovë.

Me 31 Maj 2012, në KOSTT është mbajtur takimi i parë me KPMG. U diskutua për orarin e punëve dhe caktimi i detyrave për secilin. Gjatë muajit qershor janë zhvilluar aktivitete sipas planit dinamik të projektit.

**Vendimi i ZRrE-së lidhur me kontestin e ngritur nga KOSTT sh.a. ndaj KEK sh.a.**

Me 26 Qershor 2012, KOSTT ka pranuar nga ZRrE Njoftimin lidhur me shtyrjen e afatit për 30 ditë për shqyrtimin e kontestit të inicuar nga KOSTT lidhur me refuzimin e pagesës së faturave nga KEK për Nëntor dhe Dhjetor 2011.

## 2.5. Shqyrtimi i përformancës financiare

### 2.5.1. Draft Pasqyrat Financiare: BILANCI I GJENDJES

| | Janar-Qershor/2011 | Janar-Qershor/2012 | % |
|---|---|---|---|
| **ASETETE JO QARKULLUESE** | **89,919,122** | **110,097,409** | 122.44% |
| Prona, Fabrika dhe Paisjet | 73,554,701 | 100,308,937 | **136.37%** |
| Investimet ne vijim | 16,364,420 | 9,788,472 | **59.82%** |
| **ASETET QARKULLUESE** | **35,373,638** | **29,984,931** | 84.77% |
| Stoqet,pjesët rezervë dhe veglat | 1,142,023 | 1,536,868 | **134.57%** |
| Kërkesat | 6,152,265 | 9,509,745 | **154.57%** |
| Kredi,Avanse dhe Depozita | 7,190,883 | 872,653 | **12.14%** |
| Tatimi i Parapaguar | 171,867 | 236,195 | **137.43%** |
| Paraja dhe Bilanci Bankar | 20,716,599 | 17,829,470 | **86.06%** |
| **TOTALI I MJETEVE** | **125,292,759** | **140,082,340** | **111.80%** |
| **KAPITALI I AKSIONARËVE DHE REZERVAT** | **45,774,431** | **54,862,270** | **119.85%** |
| Kapitali Aksionar | 25,000 | 25,000 | **100.00%** |
| Kapitali i trashëguar | 28,346,963 | 38,176,268 | **134.67%** |
| Fitimi i mbajtur | 14,084,667 | 15,367,648 | **109.11%** |
| | | | **0.00%** |
| **Fitimi aktual** | 3,317,801 | 1,293,354 | **38.98%** |
| **OBLIGIMET JO QARKULLUESE** | **70,459,161** | **76,240,204** | **108.20%** |
| Të hyrat e shtyera | 70,459,161 | 76,240,204 | **108.20%** |
| **OBLIGIMET QARKULLUESE** | **9,059,168** | **8,979,866** | **99.12%** |
| Obl.nga tregtia dhe obl.tjera | 9,059,168 | 8,979,866 | **99.12%** |
| **TOTAL BURIMET E MJETEVE** | **125,292,759** | **140,082,340** | **111.80%** |

*Sqarim:*

- Zvoglimi i fitimit aktual paraqitet për shkak të uljes së të hyrave nga tarifa për periudhën raportuese, në krahasim me periudhën e njejtë të vitit paraprak. Me që tarifat e vitit 2010, kanë qenë më të larta se tarifat për vitin 2011 dhe për periudhën janar-mars 2011, janë zbatuar tarifat e vitit 2010, kjo ka shkaktuar rritjen e të hyrave në krahasim me periudhën raportuese, për të cilën janë zbatuar tarifat e zvogëluara nga ZRrE.

## DRAFT PASQYRA E FITMIT DHE HUMBJES

| | Nota | Plani Janar-Qershor 2011 | Realiz. Janar-Qershor 2011 | % real/plani 2011 | Plani Janar-Qershor 2012 | Realiz. Janar-Qershor 2012 | % real/plani 2012 | % realiz 2012/2011 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Të hyrat nga tarifa | 15 | 8,140,434 | 8,362,451 | 102.7% | 7,740,257 | 6,971,071 | 90.1% | **83.4%** |
| Të hyrat tjera | 16 | 1,910,020 | 2,017,069 | 105.6% | 1,700,000 | 2,798,028 | 164.6% | **138.7%** |
| **Të hyrat totale** | | **10,050,454** | **10,379,519** | 103.3% | **9,440,257** | **9,769,099** | 103.5% | **94.1%** |
| Shpenzimet e personelit | 17 | 1,335,341 | 1,297,750 | 97.2% | 1,843,842 | 1,592,307 | 86.4% | **122.7%** |
| Shpenzimet e materialit | | 26,000 | 19,784 | 76.1% | 26,000 | 16,021 | 61.6% | **81.0%** |
| Kompenzimet Bordi i Drejtorve | | 46,563 | 44,346 | 95.2% | 21,600 | 20,760 | 96.1% | **46.8%** |
| Amortizimi | 4 | 2,675,000 | 2,719,374 | 101.7% | 3,250,000 | 4,233,150 | 130.3% | **155.7%** |
| Energjia,telofoni, uji | | 114,390 | 116,118 | 101.5% | 139,390 | 163,302 | 117.2% | **140.6%** |
| Riparime dhe mirëmbajtje | 18 | 556,650 | 373,879 | 67.2% | 819,870 | 331,468 | 40.4% | **88.7%** |
| Derivate dhe lubrifikante | | 46,601 | 44,685 | 95.9% | 51,000 | 44,809 | 87.9% | **100.3%** |
| Medicina,siguria dhe transporti | 20 | 156,000 | 111,604 | 71.5% | 150,000 | 70,598 | 47.1% | **63.3%** |
| Shpenzimet tjera operative | 19 | 373,557 | 250,547 | 67.1% | 650,524 | 370,510 | 57.0% | **147.9%** |
| Kompenzimet tjera. | | 115,000 | 13,687 | 11.9% | 27,500 | 17,757 | 64.6% | **129.7%** |
| Humbjet në bartje | 21 | 2,122,608 | 2,069,945 | 97.5% | 2,087,472 | 1,615,062 | 77.4% | **78.0%** |
| Rregullimi sekondar | | | | | | | | |
| **Shpenzimet totale** | | **7,567,710** | **7,061,718** | 93.3% | **9,067,198** | **8,475,745** | 93.5% | **120.0%** |
| **Fitimi para Tatimit** | | **2,482,744** | **3,317,802** | 133.6% | **373,059** | **1,293,354** | 346.7% | **39.0%** |
| Tatimi në fitim | 22 | | | | | | | |
| **Fitimi për periudhë** | | **2,482,744** | **3,317,802** | 133.6% | **373,059** | **1,293,354** | 346.7% | **39.0%** |

***Sqarim:***

- Të hyrat tjera janë rritur për shkak të rritjes së të hyrave të shtyera. Shkaku i rritje së tyre është aktivizimi i aseteve nga pregatitja në funksion, në fund të vitit 2011 (afër 10 milionë Euro), që do të thot se të hyrat e shtyera janë rritur për shkak të çvlerësimit të aseteve.
- Edhe rritja e amortizimit ndërlidhet me po këtë shkak
- Shpenzimet e personelit janë rritur për shkak të rritjes së numrit të punëtorëve të cilët duke filluar nga 1.04.2012 kanë kaluar nga KEK në KOSTT sipas Vendimit të Qeverisë.
- Energjia elektrike, telefoni dhe uji, janë rritur për shkak të aseteve 110 kV dhe rritjes së numrit të punëtorëve që kanë kaluar nga KEK në KOSTT. Këto ndryshime sidomos kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve në emër të energjisë elektrike, sepse është rritur numri i objekteve, në rradhë të parë i trafostacioneve.
- Shpenzimet tjera operative, po ashtu janë rritur për shkak të rritjes së aseteve dhe numrit të punëtorëve që janë transferuar nga KEK.

## 2.5.2. Analiza e IKP-ve financiare

IKP-të financiare të zgjedhura për të paraqitur përformancën financiare të KOSTT-it, janë të matshëm në baza vjetore dhe në baza kuartale. Indikatorët e paraqitur në këtë tabelë janë të matshëm në baza kuartale.

| Treguesi | IV-VI 2011 | IV-VI 2012 | Shpjegimet |
|---|---|---|---|
| **T1. Fitimi operativ margjinal** = Fitimi nëto /gjithësejt të hyrat | 0.3 | 0.1 | Qëllimi është që të jetë mbi zero.<br>Është treguesi i cili më së miri paraqet nivelin e të hyrave nga operacionët vijuese.<br>Ky tregues matë se çfarë përqindje e të hyrave të kompanisë, mbetet pasi që ajo t'i paguaj të gjitha shpenzimet variabile si: pagat, materialet, shërbimet, etj.<br>Sa më i lartë është ky tregues, kompania është në gjendje më të mirë. |
| **T2. Treguesi i qarkullimit** = asetet qarkulluese/detyrimet qarkulluese | 3.9 | 3.2 | Tregon aftësinë e kompanisë për t'i përmbushur obligimet e saj afatshkurtëra, me mjetet (asetet) e saj afatshkurtëra. Optimalja e këtij treguesi është **1.5**. |
| **T4. Mbulimi i shp.operative** = gjith.të hyrat/shpenzimet operative | 1.5 | 1.2 | Tregon raportin e të hyrave dhe shpenzimeve operative të realizuara.Treguesi duhet të jetë **më i madh ose =1** |
| **T5. Mbulimi i të hyrave** = gjiths.të hyrat/ shpenzimet e lejuara | 1.4 | 1.3 | Treguesi duhet të jetë **më i madh ose =1** |
| **T6. Mbulimi i shp. të lejuara** = shpenzimet e lejuara/gjithësejt të hyrat | 0.7 | 0.8 | Treguesi duhet të jetë **më i vogël se 1 ose =1** |
| **T7.Gjith.të hyrat ndaj të hyr.të lej** = gjiths.të hyrat e rregulluara/të hyrat e lejuara | 1.3 | 1.1 | Këtu vihen në raport vetëm të hyrat e rregulluara të realizuara dhe të hyrat e lejuara.Treguesi duhet të jetë **=1.** |
| **T12. Shpenzimet e lejuara për GWh e transmetuara** | 2.6 | 2.7 | Ky indikator ndërlidhet me metodologjinë e tarifave të ZRrE-së, e cila për periudhën raportuese ka lejuar shpenzimet totale për njësi 2.9m €/GWh. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | Ky indikator tutje analizohet duke iu referuar treguesit **T14**, që paraqet shpenzimet totale (të realizuara) për njësi, ku shihet se KOSTT ka transmetuar energji me shpenzimet reale 2.7 m €/GWh. |
| **T13. Të hyrat e lejuara për GWh e transmetuara** | 2.8 | 3.1 | Paraqet të hyrat për njësi.<br>Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike |
| **T14. Shpenzimet totale për njësi=**shp.totale/GWh e transmetuara | 2.4 | 2.9 | Objektivi: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike |

## 3. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore

| Nr | Lënda nr. | Pranë | Objekti i kontestit | Vlera e kontestit | Statusi | Statusi | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Lënda Civile nr. 2248/03 | Gjykata Komunale në Prishtinë | dëmshpërblim për lëndim në vendin e punës | **92,000.00** | Seanca me dt.23.03.2009. KOSTT ka kërkuar që lënda ti dërgohet KEK-ut për shkak të kompetencës | Seanca e caktuar për dt.14.07..2009, u mbajt me vonesë, KOSTT ia ka dorëzuar Përgjigjen në Padi Gjykatës dhe në seancë në tërësi hedh poshtë kërkesëpadinë e Paditësit si të pabazë.Pritet Aktgjykimi. | Seanca 01.04/11, shtyhet dhe seanca e dt.21.04 për dt.12.05/11.Gjykata pjesërisht aprovon kërkesë padinë në vlerë 5000€.Ankesa e KOSTT-it në shkallë të II-të. |
| 2 | Lënda penale nr.326/05 | Gjykata Komunale në Kaçanik | vjedhje | **2,370.00** | Seanca e rradhës u caktua për datën 18.11.2008; shtyhet 30.01;shtyhet 30.03.2009 | Seanca e përfundimtare me dt.17.03/09, është mbajtë Aktgjykimi.-është pranu, Lënda me Ankesë nga Prokurori të dt.08.04.2009 | Verifikimi i fundit i lëndës-29.06/10, ende e pakryer. |
| 3 | Lënda Civile nr.85/05 | Gjykata Komunale në Prishtinë | kompensim i dëmit | **50,000.00** | Seanca e rradhës është caktuar për datën 24.12.2008 | Seanca e rradhës është caktuar për dt.10.02.2009, Mbahet seanca përfundimtare dt.11.06.2009. Refuzohet Kërkesëpadia e Paditësit. | Lënda me Ankesë në GjQ.Me Aktgjykimin Ac.1003/09, Refuzohet Ankesa e palës. Lënda me Revizion në Gj.Supreme. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Lënda civile C1.nr.505/07 | Gjykata Komunale në Prishtinë | pagesa e kamatës ligjore | nuk ka | Përfaqësuesi i KEK-ut ka refuzuar pjesëmarrjen në seanca pa prezencën e KOSTT-it. | Është caktuar seanca me dt.01.04.2009, shtyhet. KOSTT parashtron Ankesë ne GjQ-Pr, kundër Aktgjykimit C1 505/07. Seanca e rradhës, dt.06.05.2010. | Aktgjykimi nuk është i formës së prerë |
| 5 | Lënda penale nr. 2406/ 06 | Gjykata Komunale në Prishtinë | vjedhje | **15,398.00** | Aktgjykimi në favor të KOSTT-it por nuk është bërë akoma i plotfuqishëm | Verifikim me dt.11.06/09, Aktgjykimi nuk i është dorëzuar të Padituve, nga dt12.06, do t'i dorëzohet me polici | Miratim i pjesshëm i Ankesës, Gjykata e Qarkut Pr.Propozim Ekzekutimi ne afatin ligjor. |
| 6 | Lënda penale nr.320/06 | Gjykata Komunale në Kaçanik | vjedhje e rëndë | **9,120.00** | Seanca e rradhës është caktuar për datën 14.11.2008 | Seanca e caktuar për dt.27.01.2009 është mbajtur dhe pritet Aktgjykimi | Aktgjykimi me Ankesë, në GjQ, nga dt.19.03/09 Verifikimi i fundit 29.06.2010. |
| 7 | Lënda penale 284/06 | Gjykata Komunale në Lipjan | vjedhje e rëndë | Nuk është përcaktuar | KOSTT ka ushtruar Ankesën për zgjedhje të pjesërishme (vlera e kontestit) | | .Lënda me Ankesë, pritet përgjigja nga Gjykata e Qarkut. |
| 8 | Lënda civile nr. 409/06 | Gjykata Komunale në Prishtinë | Lirimi i banesës | nuk ka | Seanca e rradhës nuk është mbajturur, pritet caktimi i seancës tjetër | Seanca e caktuar gabimisht nga Gjykata me dt.04.01/10 (ditë pushimi). | Seanca e rradhës nuk është caktuar ende. |
| 9 | Lënda civile nr.511/00 | Gjykata Komunale në Prishtinë | lirimi i lokaleve në Kurriz | nuk ka | Kontesti ka përfunduar pozitivisht për KOSTT-in. Pritet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale | Aktgjykimi është marrë, në proces është propozimi për ekzekutim. | Ende nuk është kryer. (Paraprakisht marrëveshja me palët për lirim të lokaleve). Lënda meAnkesë GjQPr. KOSTT, ka |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | në Prishtinë | | parashtrua Urgjencë GJQarkut-PR. Urgjenca e dytë, 06/12 |
| 10 | Lënda civile nr. 2168/04 | Gjykata Komunale në Prishtinë | lirimi i lokalit nga gjellëtorja në Kurriz | nuk ka | Seanca e rradhës u caktua për datën 19.11.2008 | Dalja në vend me Gjykatën, dt.23.04/09, pritet Raporti i Ekspertit. | Seanca e rradhës me dt.17.04/09, (Përfaqëson KEK-u). Pengohet puna e Ekspertit nga Pala. Njoftohet Gjykata. KOSTT parashtron Urgjencë në vazhdimin e çështjes GjK-Pr. |
| 11 | Lënda civile C.nr.588/08 | Gjykata Komunale në Gjakovë | Kompenzim dëmi | **10000** | Seanca u caktua për dt.19.01.2009 | Seanca e rradhës në afat të pacaktuar | KOSTT, sipas Aktvendimit C.nr.136/09 paraqet përgjigje në Padi, me dt.28.04.2009.Ne precizim te Padis KOSTT dt.27.03.2012, parashtron pergjigje ne Padi te C.nr.588/08 |
| 12 | C.156/09 | Gjykata Komunale Prizren | Kompenzim dëmi | | I parashtruar me dt.11.03/09. | | Pritet caktimi i seancës se radhes. |
| 13 | Lëndë civile , Padi | Gjykata Komunale Ferizaj | kompenzimi i dëmit | 200,00€ | Padia e dorëzuar në Gjykatë ,26.06/09 | Pritet caktimi i seancës. | Të hiqet nga agjenda për shkak të vonesave dhe vlerës së vogël |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | C.nr.1559/06 | Gjykata Komunale Prishtinë | pagesa e Rentës. | | KEK ka paguar - Qershor/2006. | Seanca e 06.05; 04.06, 08.07 dhe shtyhet 26.10/10 | KOSTT ka dhënë dëshminë mbi legjitimitet pasiv. |
| 15 | C.nr. 270/07 | Gjykata Komunale Podujevë | Kompenzim dami | **100.000,€** | KOSTT- I padituri III-të (Tretë) | seancat e dt:10.09; dhe 12.10/10 dorëzimi i shkresave të lendës KOSTT-it | Seanca e radhës sipas ftesës. |
| 16 | A.nr.888/10 | Gjykata Supreme e Kosovës | | | | | Në këtë kontest KOSTT ka përfituar rreth 6000€ për çdo vit. |
| 17 | C.nr.218/11 | Gjykata Komunale Ferizaj | Pengim Posedi | 500 € | KOSTT- ka parashtrua Përgjigje në Padi sipas Aktvendimit të Gjykatës | Seanca e dt. 20.06/11, shtyhet me 04.07; shtyhet me 05.09/11.Seanca e radhës dt.27.10/11 | Lënda e kryer në Shkallën e I-rë. KOSTT-parashtron Ankesë Gj.Qarkut-PR. |
| 18 | C.nr.503/11 | GJYKATA Komunale Pejë | Pengim Posedi | nn | Sipas kërkesës së Gjykatës, KOSTT ka parashtruar precizimin e Padisë. | Pritet ftesa për seancë(para seancës sqarime me Gjyqtarin) | |
| 19 | C.nr.2255/06 | GjK-Prishtine | Kompenzim dami | nn | Sipas kërkesës së të Atorizuarit të Paditëses me zgjerim të Padisë | Pergjigja ne Padi sipas Akt. Gjyqësore u dorëzua 12.11.2011. | Seanca Gjyqësore sipas ftesës. |
| 20 | A.nr.801/12 | Gjykata Supreme e Kosovës | Masa e Përkohshme | nn | | | Seanca Gjyqësore 29.06/12, Refuzohet propozimi A.nr.801/12. |

**Sqarim:** Lënda nr. 503/11 dhe lënda C.nr. 2255/06 janë lëndë të reja.

### 3.1. Procedurat gjyqësore që pritet të ndërmirren gjatë tremujorit aktual (korrik - shtator )

Në ndryshim prej sektorëve tjerë qështjet Gjyqësore, jo te gjitha mund të parashifen në periudha të caktuara, për shkak se ato vijnë në shprehje si kundërveprim i nje qeshtjeje ad-hoc.Konkretisht, procedurat i kanë afatet e tyre Ligjore dhe në shumicën e rasteve nuk mund të lidhen për tremujorë.

# 4. Kontratat/transakcionet e konsiderueshme gjatë tremujorit të dytë të vitit 2012 nga burimet e KOSTT

| Nr | Departmenti | Lloji i Prokurimit | Nr I Procedures | Emri I Projektit | KONTRAKTORËT | Vlera e Kontratës | Vlera e Realizuar e Kontrates | Vlera e mbetur për realizim | Burimet e Financimit | Përqindja e Realizimit | Nr. I Protokolit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Departamenti i Burimeve Njerëzore | Procedure e negociuar | 1 | Mirëmbajtja e CAS-it | KOMTEL PE | 240,000.00 € | 0.00 € | 240,000.00 € | KOSTT-Buxhet | 0.00% | nr:206 dt:17.06.2012 |
| 2 | Departamenti i Burimeve Njerëzore | Mini Konkurenca-Kontrate kornize | 4 | FPO Nr.2-Furnizim me Servera | KOMTEL PE | 70,766.32 € | 0.00 € | 70,766.32 € | KOSTT-Buxhet | 0.00% | nr.237 dt.07.06.2012 |
| 3 | Departamenti i Operatorit te Transmisionit | Procedure e negociuar | 9 | Rehabilitimi i NS Prishtina 3 | ENERGOINVEST | 253,900.00 € | 0.00 € | 253,900.00 € | KOSTT-Buxhet | 0.00% | nr.260 dt.09/07/2012 |
| 4 | Departamenti i Operatorit te Transmisionit | Procedure e hapur | 15 | LOT 1: Furnizim me Pjese Rezerve per Nenstacione | Rima - enginieering | 139,624.56 € | 0.00 € | 139,624.56 € | KOSTT-Buxhet | 0.00% | nr.259 dt.04/07/2012 |
| 5 | Departamenti i Operatorit te Transmisionit | Procedure e hapur | 15 | LOT 2: Furnizim me Izolatorë dhe Kleme | UKAB | 162,900.00 € | 0.00 € | 162,900.00 € | KOSTT-Buxhet | 0.00% | nr.257 dt.04/07/2012 |
| 6 | Departamenti per Menaxhim te Projekteve dhe Inxhinieri | Procedure e hapur | 18 | Asfaltimi i Rruges se qasjes për në NS 400/110 kV Peja 3 | Lika Trade | 167,927.40 € | 0.00 € | 167,927.40 € | KOSTT-Buxhet | 0.00% | NR.238 DT.13.06.2012 |
| 7 | Departamenti i Burimeve Njerëzore | Procedure e hapur | 21 | Sigurimi Shëndetësor i Punëtorëve | SIGAL | 556,800.00 € | 0.00 € | 556,800.00 € | KOSTT-Buxhet | 0.00% | nr.252 dt.27.06.2012 |
| 8 | Departamenti i Operatorit te Transmisionit | Procedure e hapur | 22 | Furnizim me Karburante për Automjete dhe Gjeneratora | Petrol Oti Slovenija | 350,000.00 € | 8,961.89 € | 341,038.11 € | KOSTT-Buxhet | 2.56% | nr.220 dt.28.05.2012 |
| 9 | Zyra per SI dhe MKZ | Procedure e hapur | 25 | Furnizim me Pajisje Personale Mbrojtese | Ripten Engineering | 50,000.00 € | 0.00 € | 50,000.00 € | KOSTT-Buxhet | 0.00% | nr.227 dt.29.05.2012 |
| 10 | Departamenti i Burimeve Njerëzore | Mini Konkurenca-Kontrate kornize | 58/11 | Furnizim me Softuer-Ftesa per Ofertim Nr1 | PPC IT | 290,687.12 € | 289,814.96 € | 872.16 € | KOSTT-Buxhet | 99.70% | nr.67 dt.16/03/2012 |
| | | | | | TOTALI | 2,282,605.40 € | 298,776.85 € | 1,983,828.55 € | | 13.09% | |

## 5. Propozimet për ngritjen e performancës në KOSTT

Në mënyrë që KOSTT të rritë edhe më tutje performancën, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet:

- Implementimit të projekteve kryesore që risin kapacitetet e operimit e që lidhen me operimin e mëvetësishëm të KOSTT;
- Vazhdimi i trajnimit të stafit dhe formave tjera të zhvillimit që ritë shkathtësitë e tyre dhe efiçiencën e KOSTT;
- Vazhdimi i shqyrtimit të masave motivuese për stafin për ngritjen e kualitetit të punës së tyre.
- Futja e teknologjisë, respektivisht pajisja e të gjitha objekteve (NS-ve) me pajisje të teknologjisë për monitorimin më të mirë të punëtorëve si: terminalet e kontrollës kohore, kompjuter etj.;

## Shtojcë: Raport mbi funkcionimin e Qeverisjes Korporative të KOSTT-it

Raporti mbi funcionimin e Qeverisjes Korporative përfshinë aktivitetet e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it, bazuar në Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Statutin e Kompanisë dhe Rregulloren e Punës së Bordit. Ky Raport gjithashtu përfshinë edhe punën e Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera të themeluara nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it.

Raporti mbi funcionimin e Qeverisjes Korporative përfshinë aktivitetet e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it, bazuar në Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Statutin e Kompanisë dhe Rregulloren e Punës së Bordit. Ky Raport gjithashtu përfshinë edhe punën e Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera të themeluara nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it.

Për periudhën raportuese Prill – Qershor 2012 Bordi ka mbajtur 3 (tri) mbledhje të rregullta dhe (1) një të jashtëzakonshme. Kurse Komisioni i Auditimit ka mbajtur 2 (dy) mbledhje të rregullta. Gjatë kësaj periudhe Komisioni për Projekte kapitale ka mbajtur dy mbledhje, ndërsa Komisioni për projektin e Linjës 400kV Kosovë - Shqipëri ka mbajtur 1 (nje) mbledhje.

Gjatë periudhës raportuese në pajtime me Ligjin për Ndërmarrje Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare gjithashtu është mbajtur Mbledhja e përgjithshme vjetore me aksionarin.

Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit janë mbajtur në periudhat kohore sipas Planit të aprovuar të Punës së Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2012.

Çdo mbledhje e rregullt e Bordit ka trajtuar disa pika që paraqiten si pika të rëndomta dhe përfshijnë: vërtetimin e kuorumit dhe aprovimin e rendit të ditës, aprovimin e procesverbaleve nga mbledhjet paraprake të Bordit të Drejtorëve dhe të Komisioneve, raportin nga mbledhja e Komisionit të Auditimit dhe Raportin e Kryeshefit Ekzekutiv.

Mbledhjet në vijim janë paraqitur sipas datës së mbajtjes së tyre.

### I. Komisioni për Projekte Kapitale

Gjatë periudhës raportuese Komisioni për projekte kapitale ka mbajtur dy mbledhje në të cilat Komisioni është njoftuar për progresin në implementimin e projekteve kapitale të KOSTT.

Në këtë mbledhje Komisioni për Projekte Kapitale është njoftuar për progresin në implementimin e projekteve kapitale të KOSTT si dhe për pengesat apo vonesat eventuale. Gjithashtu është kërkuar nga Departamenti për Menaxhimin e Projketeve dhe Inxhinieri që të jetë vigjilentë në zbatimin e kontratave për implementimin e projekteve.

## II. Komisioni për Projektin e Linjës 400kV Kosovë – Shqipëri

Gjatë periudhës raportuese Komisioni për linjën 400kV Kosovë - Shqipëri ka mbajtur një mbledhje. Në këtë mbledhje komisioni është njoftuar për progresin e arritur në implemtimin e projektit, përkatësisht vonesat. Vonesat në implementim janë paraqitur për shkak të hezitimeve nga OST për pranimin e rezultateve të vlerësimit të ofertave nga komisioni i përbashkët vlerësues. Kjo situatë është paraqitur për shkak të brengave të ngritura nga OST për ndryshimin e madh të çmimeve ndërmjet ofertuesit fitues dhe ofertuesit të ranguar si i dyti. Lidhur me këtë çështje KOSTT ka zhvilluar një sërë takimesh me OST, KfW, etj për të gjetur zgjidhje për këtë situatë.

## III. Komisioni i Audimit

Gjatë periudhës raportuese Komisioni i Audimit ka mbajtur 2 mbledhje. Në këto mbledhje Komisioni i Audimit në përmbshje të funksionit të vet ligjor ka shqyrtuar dokumentet e paraqitura sipas rendit të ditës dhe bordit i ka paraqitur rekomandimet përkatëse.
Më hollësisht, Komisioni i auditimit gjatë periudhës raportuese ka shqyrtuar këtë dokumente dhe ka dhenë rekomandimet përkatëse.

**Në Mbledhjen e 27/12 e datës 6 maj 2012 Komisioni i Audimit ka shqyrtyar**

1. **Draft Raportit vjetor 2011 të KOSTT-it- rekomandimet për Bord**

Komisioni i Auditimit pas shqyrtimit dhe diskutimit rreth draft Raportit vjetor të KOSTT për vitin 2011 konstatoi se raporti i prezantuar është i sintetizuar në mënyrë mjaft profesionale, i përmban të gjitha elementet që i kërkon NJPMNP konform dispozitave ligjore të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe ligjeve tjera të aplikueshme në Kosovë, duke i përfshirë edhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe është një material i vlefshëm për shqyrtim dhe analizim të afarizmit të KOSTT-it për periudhën 1 janar 2011- 31 dhjetor 2011 dhe i rekomandon BD për shqyrtim dhe aprovim të njëjtit.
Komisioni i Auditimit i sugjeron shërbimet profesionale që ti marrin parasysh vërejtjet dhe ta paraqesin versionin final të Raportit vjetor 2011 në mbledhjen e BD.

2. **Kërkesë për sigurimin e mjeteve buxhetore për furnizimin/blerjen e 2 (dy) Firewalls për Projektin e TI për Operim të Tregut - rekomandimet për Bord**

Komisioni i Auditimit shqyrtoi kërkesën e prezantuar. Komisioni i Auditimit konstatoi si në vijim:

- KE do të përgatis një shkresë për BD, e cila ka me qenë mbështetëse për vendim të BD
-Obligohen shërbimet profesionale që me rastin e rishikimit të buxhetit të kyqet edhe pjesa tjetër në buxhetin e vitit 2012.
-Të referohet për situatën e këtij projekti nga Drejtorët e Departamenteve, Drejtori i Operimit të Tregut dhe Drejtori i Departamentit të Projekteve në mbledhjen e BD.

3. **Shqyrtimi i draft Rregullorës për Pagesat e Shërbimeve Komunale-rekomandimet për Bord**

Komisioni i Auditimit shqyrtoi draft Rregulloren e prezantuar.Sekretari i kompanisë informoi se kjo rregullore është referuar në urdhëresën administrative nr.06/2008 e cila është nxjerrë për pagesat e Shërbimeve Komunale.
Komisioni i Auditimit pas shqyrtimit dhe diskutimit të draft Rregullores për pagesat e shërbimeve komunale dhe inkorporimit të vërejtjeve perkatëse i rekomandon BD për shqyrtim dhe aprovim me sugjerimet e dhëna më lart.

**Në mbledhjen e 28/12 të datës 25 prill 2012 Komisioni i Audimit ka shqyrtuar:**

1. **Shqyrtimi i draft Raportit të Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin 2011**

Komisioni i Auditimit ka shqyrtuar draft Raportin e Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin 2011.
Komisioni i Auditimit pas diskutimit rreth kësaj pike konstatoi si në vijim:

- Pasi në ndërkohë ka ardhur deri te ndryshimi i pasqyrave të gjendjes, pasi Auditori mund të kërkoj ndryshime në aspektin formal juridik dhe konform standardeve sugjeroi që:
- Për BD të përgatitet një pasqyrë e ndryshimeve për raportin e Auditorit dhe ti bashkëngjitet të njëjtit raport.

2. **Shqyrtimi i Letrës së Menaxhmentit për vitin 2011**

Zyrtari Kryesor Financiar në prezantimin e letrës së menaxhemntit theksoi se e vetmja çështje e theksuar në Letër Menaxhmentin është një rekomandim i auditorit për çështjen e aseteve, pasi ende nuk janë në emër të KOSTT. Kjo çështje e pazgjidhur po përcillet nga viti i kaluar.
Komisioni i Auditimit konstatoi:
Prej raportit të kaluar të auditorit janë eliminuar gjitha rekomandimet përveç çështjes së aseteve, e cila në njohuri të BD është në zhvillim.
Komisioni i Auditimit pas shqyrtimit i dërgon raportin e auditorit BD me rekomandimin se ky raport shpreh gjendjen reale të afarizimit në NP. Kjo është meritë e strukturave menaxhuese dhe BD.

3. **Shqyrtimi i kërkesës për sigurimin e mjeteve buxhetore shtesë për pagat e punëtorëve të transferuar nga KEK në KOSTT**

Komisioni i Auditimit rekomandon BD shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës duke konsideruar Financim i përkohshëm deri në aprovimin e tarifave dhe revidimin e buxhetit dhe kjo të aplikohet për dy muajt Prill e Maj e mëtutje sipas nevojës.

4. **Shqyrtimi i kërkesës për sigurimin e mjeteve buxhetore shtesë për projektin e fasades së KOSTT-it**

Komisioni i Auditimit pas shqyrtimit dhe diskutimit sugjeroi që kërkesa t'i përcillet BD me rekomandimin për aprovim.

5. **Infomatë për shkresën e pranuar nga NJPMNP për Stimulimin e Efektshmërisë në punën e Bordit të drejtorëve të NP-ve**

Sekretari i Kompanise njoftoi për shkresën e dërguar nga NJPMNP, e cila ndërlidhet me procedurat e punës. Komisioni i Auditimit i rekomandon BD që të harmonizon kompenzimin për stimulimin e efektshmërisë sipas udhëzimeve që i ka dhënë NJPMNP

6. **Çështja e komisionit për ndarjen e aseteve KOSTT-KEK**

Fakti se është bërë ndarja dhe është transferuar pasuria prej datës 1 prill 2012, Komisioni i Auditmit i rekomandon BD që të merr vendim për shuarjen e këtij komisioni përfundimisht me datën31 mars 2012.

7. **Njoftim me Raportin e Zyrtarit për Auditim të Brendshëm**

z.Rexhepi njoftoi për auditimin e kryer në ndërmarrje duke theksuar se ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë, janë diskutuar të gjitha materialet dhe ka përmirësime.
Komisioni i Auditimit konstatoi se Raporti i AB është në vazhdën e raporteve tjera që e rrisin nivelin e performances të auditimit dhe se ka korigjime prej atyre më të hershme dhe e pranoi Raportin si të tillë.

8. **Informatë nga NJPMNP për listën e dokumenteve që mungojnë prej NP**

Sekretari i Kompanisë informoi për kërkesën e pranuar nga NJPMNP.Komisioni i Auditmit sugjeroi që:

- Për BD urgjent të përgatitet materiali: Kontratat e prokurimit të lidhura pa procedura të prokurimit dhe ato që janë respektuar kushtet e tregut

## IV. Bordi i Drejtorëve

Gjatë periudhës raportuese Bordi i Drejtorëve në përmbuushje të detyrave sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe në zbatim të detyrave fiduciare ka mbajtur gjithsejt tri (3) mbledhje, nga të cilat dy (2) të rregullta dhe një (1) të jashtëzakonshme. Në vijim janë paraqitur çështjet e adresuara dhe vendimet e marra në kuadër të këtyre mbledhjeve

**Në mbledhjen e 27/12 e dates 15 mars Bordi i Drejtorëve ka shqyrtuar dhe marrë vendime mbi çështjet vijuese:**

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i draft Raportit vjetor të KOSTT-it për vitin 2011**

BD shqyrtoi Raportin vjetor të KOSTT për vitin 2011 dhe konstatoi se Raporti vjetor ka të dhëna të mjaftueshme dhe i përmban të gjitha elementet, i përmbush të gjitha kriteret për publikim dhe është përpiluar edhe konform kodit etik dhe urdhëresës administrative në formën që i plotëson nevojat.

BD propozoi që Raporti vjetor i KOSTT për vitin 2011 me vërejtjet e sugjerimet e dhëna nga BD të aprovohet.

Vendimi - 120315–II/5

BD njëzëri aprovoi Raportin vjetor të KOSTT për vitin 2011 me plotësimet sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna.

**2. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për sigurimin e mjeteve buxhetore për furnizimin/blerjen e 2 (dy) Firewalls për projektin e TI për Operim të Tregut**

BD pas shqyrtimit të kërkesë së prezantuar nga KE me propozimin për marrje të vendimit për blerje të 2(dy) Firewalls për mbrojtjen e sistemit sugjeroi që burimet adekuate të gjinden nga burimet financiare të propozuara nga ZKFTH vetëm për furnizim.

Vendimi - 120315–II/6

BD njëzëri aprovoi vendimin për blerje të 2(dy) Firewalls për mbrojtjen e sistemit TI për Operim të Tregut dhe sugjeroi që burimet adekuate të gjinden nga burimet financiare të propozuara nga ZKFTH dhe kjo të shkon vetëm për furnizim

**3. Shqyrtimi dhe aprovimi i rregullores për pagesën e shërbimeve komunale**

BD u njoftua se Komisioni i Auditimit e ka shqyrtuar dhe e ka pa të arsyeshme që të aprovohet një rregullore të tillë.

Vendimi - 120315–II/7

BD njëzëri aprovoi Rregulloren për pagesën e shërbimeve komunale për vlerësimin e dëmeve eventuale gjatë ndërtimit të objekteve elektroenergjetike të Sistemit transmetues (niveli i tensionit 400,220 dhe 110 kV).

**4.Kërkesa për sigurimin e mjeteve shtesë për rehabilitimin e paisjeve NS Kosova B në vlerë prej 30.000 €**

Vendimi - 120315–II/8.1

BD njëzëri aprovoi buxhetin shtesë në bazë të kërkesës së parashtruar për sigurimin e mjeteve shtesë për rehabilitimin e paisjeve NS Kosova B në vlerë prej 30.000.00 €

**5.Shqyrtimi i Marrëveshjes për kufirin e ri ndarës KOSTT-KEK**

BD u njoftua për nënshkrimin e Marrëveshjes KOSTT-KEK për transferimin e aseteve 400/200/110 kV dhe aprovimin e të njëjtës nga Ministria e zhvillimit ekonomik. Bazuar në këtë Marrëveshje BD kërkon nga Menaxhmenti implementimin e Marrëveshjes në bazë të afateve të dhëna në këtë Marrëveshje dhe pas përfundimit ta bëj raportin final për BD.
Pastaj BD propozoi që të merret vendim për implementimin e Marrëveshjes për kufirin e ri ndarës KOSTT-KEK.

<u>Vendimi - 120315–II/8.2</u>
BD njëzëri aprovoi vendimin për implementimin e Marrëveshjes për kufirin e ri ndarës KOSTT-KEK në bazë të afateve të dhëna në këtë Marrëveshje dhe pas përfundimit do ta përgatis raportin final për BD.
Mbetet obligim i shërbimeve profesionale për implementim të kësaj Marrëveshje në bazë të afateve të dhëna.

**Në mbledhjen e 28/12 të dates 30 prill 2012 Bordi i Drejtorëve ka shqyrtuar dhe marrë vendime mbi çështjet vijuese:**

**<u>1. Shqyrtimi i draft Raportit të Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin 2011</u>**

BD u informua me Raportin e Auditorit të Pavarur dhe PF për vitin 2011 dhe pas shqyrtimit dhe analizimit doli me këtë konstatim:

- BD dhe shërbimet profesionale i kanë kryer detyrat e parashtruara dhe konstatoi se ky është auditimi i gjashtë(6) me radhë i cili jepet nga Auditori pa kualifikime.

**<u>2. Shqyrtimi i Letrës së Menaxhmentit për vitin 2011</u>**

BD konstatoi se e vetmja çështje e theksuar në Letër Menaxhmentin është një rekomandim i auditorit për çështjen e aseteve, pasi ende nuk janë në emër të KOSTT. Kjo çështje e pazgjidhur po përcillet nga viti i kaluar.
Pastaj BD doli me një konstatim:

- Me kufirin e ri ndarës KOSTT-KEK shërbimet profesionale dhe BD do të merren më tepër me këtë çështje në të ardhmen që ta gjejnë zgjidhjen.

**<u>3.Shqyrtimi i kërkesës për sigurimin e mjeteve buxhetore shtesë për pagat e punëtorëve të transferuar nga KEK në KOSTT.</u>**

BD shqyrtoi kërkesën e prezantuar dhe propozoi që të gjendet një formë e përkohshme e pagesës për pagat e operatoreve të transferuar deri në rishikimin e buxhetit për vitin 2012.

- Bordi sugjeroi që Menaxhmenti ti ndërmerr masat për vlerësimin e gjendjes teknike që të inkorporohet kjo pjesë në KOSTT.

<u>Vendimi - 120430–II/7</u>
BD njëzëri aprovoi vendimin për sigurimin e mjeteve buxhetore shtesë për pagat e punëtorëve të transferuar nga KEK në KOSTT nga buxheti i pagave si huazim deri në aprovimin e buxhetit të reviduar pas aprovimit të tarifave.

**4. Shqyrtimi i kërkesës për sigurimin e mjeteve buxhetore shtesë për projektin e fasadës së KOSTT-it**

BD pasi shqyrtoi kërkesën e prezantuar konstatoi:

- Kjo çështje shtyhet për mbledhjen tjetër dhe i rekomandon shërbimeve profesionale që të përgatitet një material i përbashkët për projektin duke përfshirë çështjen e renovimit dhe fasadës.

**5. Shqyrtimi i draft Raportit nga mbledhja e 6-të e Komisionit për Linjën 400kV Kosovë-Shqipëri**

BD u njoftua me draft Raportin e prezantuar nga mbledhja e 6-të e Komisionit për Linjen 400 kV Kosovë-Shqipëri.

**6. Shqyrtimi i draft Raportit nga mbledhja e 7-të e Komisionit për Projekte Kapitale**

BD u njoftua me draft Raportin e prezantuar nga mbledhja e 7-të e Komisionit për Projekte kapitale dhe për shtesat në faqe 5 e tutje.

**7. Çështja e Komisionit për ndarjen e aseteve KEK-KOSTT**

BD shqyrtoi çështjen e Komisionit për ndarjen e aseteve KEK-KOSTT në përbërjen e vjetër me anëtarët e BD. Kjo për arsye se kufiri i ri ndarës mes KOSTT-KEK u ba me datën 31 mars 2012 dhe komisioni më nuk ka efekt të ekzistoj, por mund të formohet komisioni i ri sipas nevojës.

**8. Deklarata e Bordit për kontratat një-burrimore bazuar në kërkesën nga NJPMNP**

Lidhur me këtë pikë BD konstatoi:

- Duke u bazuar në lejet /pëlqimet e APP dhe KRPP që kanë qenë të njoftuar me kohë dhe i kanë aprovuar këto, BD mbështet prokurimet njëburimore të paraqitura në materialin e bashkangjitur.

Kryesuesi i Bordit në emër të Bordit ka nënshkruar Deklaretën për kontratat një-burrimore e cila do të dërgohet NJPMNP-së. Bordi ka kërkuar që prokurimet një burimore në të ardhmën të prezantohen dhe arsyetohen para Bordit. Në raste të jashtzakonshme (emergjente) Menaxhementi i KOSTT-it merr Vendim kurse në mbledhjen e parë të ardhshme i raportohet Bordit për arsyeshmerine e Vendimit.

**9. Infomatë për shkresën e pranuar nga NJPMNP për Stimulimin e Efektshmërisë në punën e Bordit të drejtorëve të NP-ve.**

BD u informue me shkresën e dërguar nga NJPMNP për stimulimin e efektshmërisë së punës së BD të NP-ve. Kryesuesi i BD nënshkroi deklaratën e përgatitur për NJPMNP dhe propozoi që të implementohet pjesa e mbetur për performancen për BD nga shërbimet menaxhuese.

**NË MBLEDHJEN E 29/12 TË DATËS 17 MAJ 2012 BORDI I DREJTORËVE KA SHQYRTUAR DHE MARRË VENDIME MBI ÇËSHTJET VIJUESE:**

**1. Shqyrtimi i draft Raportit tremujor për periudhën Janar-Mars 2012**

BD shqyrtoi Raportin e prezantuar për tremujorin e parë Janar-Mars 2012 dhe mori sqarimet e pikave të cilat ishin në interesim.

BD u njoftua se Propozimi i Komisionit të Auditmit ishte se pasi ka numër të madh të indikatorëve teknik e financiar, të cilat nuk kërkohen nga ZRE, në të ardhmen këta indikatorë të grupohen në indikatorët që janë të nevojshme në punën e KOSTT, ndërsa për nevojat e BD përveç raporteve sintetike të jepet çdo shënim.

Vendimi - 120517–II/5

BD njëzëri aprovoi Raportin tremujor për periudhën Janar-Mars 2012 duke vlerësuar se Raporti tremujor Janar-Mars 2012 është gjithëpërfshirës dhe i përmban elementet konform Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe konform standardeve ndërkombëtare.

**1. Informatë për zgjedhjen e Merita Kostarit në Bordin e ZRRE**

BD mori informatën nga Sekretari i kompanisë Merita Kostari për emërimin e saj në Bordin e Zyres të Rregullatorit të Energjisë nga Parlamenti.

BD pranoi informatën mbi zgjedhjen e Merita Kostari në BD të ZRRE dhe rekomandoi që mëtutje të veprohet sipas procedurave përkatëse.

**2. Shqyrtimi i kërkesës për mbështetje financiare**

BD shqyrtoi kërkesën e parashtruar nga Universiteti publik "Haxhi Zeka" FSHAB, Pejë për mbështetje financiare për organizimin e konferencës së dytë shkencore me titull "Society internanationalization-affectivity and problems" me pjesëmarrje ndërkombëtare.

Pstaj BD propozoi që të merret vendim për kërkesën e parashtruar.

Vendimi - 120517–II/7.2

BD njëzëri aprovoi vendimin për aprovimin e kërkesës dhe ndarjen e mjeteve në vlerë prej 900 € në emër të donacionit për Universitetin publik "Haxhi Zeka" FSHAB, Pejë për organizimin e konferencës së dytë shkencore me titull "Society internanationalization-affectivity and problems" me pjesëmarrje ndërkombëtare.

**NË MBLEDHJEN E 29.1/12 TË DATËS 8 QERSHOR 2012 BORDI I DREJTORËVE KA SHQYRTUAR DHE MARRË VENDIME MBI ÇËSHTJET VIJUESE:**

z.Ramadan Paçarada e hapi mbledhjen e jashtëzakonshme nr. 29.1 të Bordit të Drejtorëve me konstatimin se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes me praninë e pesë anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe se materiali për mbledhje është dërguar me kohë.

Kryesuesi informoi se mbledhja e jashtëzakonshme e BD është thirrur që të emërohet një zyrtar i cili do ti kryej punët e Sekretarit të Kompanisë si Ushtrues Detyre, pasi që Sekretarja e Kompanisë Merita Kostari është zgjedhur në BD të ZRRE.

**1 . Kërkesa për miratimin e buxhetit shtesë për projektin "Asfaltimi i rrugës së qasjes në NS Peja 3**

Bordi i Drejtorëve shqyrtoi kërkesën dhe vlerësoi arsyetimin për ndarjen e mjeteve shtesë për projektin Asfaltimi i rrugës së qasjes në NS 400/110/10 kV –Peja 3 në vlerë rreth 20.000,00 € më shumë prej buxhetit të planifikuar.

Vendimi – 120608-2

BD njëzëri aprovoi kërkesën dhe miratoi vendimin për ndarjen e buxhetit shtesë në vlerë rreth 20.000,00 € më shumë prej buxhetit të planifikuar për projektin "Asfaltimi i rrugës për qasje në NS Peja 3".

**2. Informata për dorëheqjen e Sekretarit të kompanisë dhe propozimi për emërimin e ushtruesit të detyrës të Sekretarit të Kompanisë**

BD u informua me dorëheqjen e Sekretarit të Kompanisë Merita Kostari dhe shqyrtoi propozimin për emërimin e Ushtruesit të Detyrës të Sekretarit të Kompanisë.
BD konstatoi se në mbledhjen e rregullt të BD të datës 17 Maj 2012 Sekretari i Kompanisë Merita Kostari e ka informuar BD se Kuvendi e ka emëruar anëtare në BD të ZRRE, derisa në këtë mbledhje shqyrtohet dorëheqja e Merita Kostarit nga pozita e Sekretarit të kompanisë KOSTT.

Pastaj BD shqyrtoi propozimin e paraqitur nga KE për emërimin e z.Visar Hoxha, Ushtrues Detyre i Sekretarit të Kompanisë me të gjitha të drejtat dhe autorizimet deri në zgjedhjen e rregullt të Sekretarit të Kompanisë konform dispozitave ligjore.

Vendimi – 120608-3

BD njëzëri aprovoi vendimin mbi emërimin e z. Visar Hoxha UD i Sekretarit të kompanisë me të gjitha të drejtat dhe autorizimet sikur edhe Sekretari i rregullt i kompanisë.
Ky vendim hyn në fuqi nga dita e marrjes së vendimit me të gjitha të drejtat dhe obligimet që i përcakton ligji dhe vlen deri në zgjedhjen e rregullt të Sekretarit të Kompanisë konform dispozitave ligjore.

**3. Shkresa nga NJPMNP për mbajtjen e mbledhjes të përgjithshme vjetore me aksionarin**

BD u informua me shkresën nga NJPMNP për thirrjen e mbledhjes të përgjithshme vjetore me aksionarin me pikat e rendit të ditës të parashikuar nga Ligji dhe Kodi i Etikës dhe pikat tjera të domosdoshme sipas orarit të caktuar për KOSTT me datën 28.06.2012 nga ora 10:00.

**Informatë për Draft Raportin e Auditorit të Jashtëm të PF 2011**
ZKFTH informoi BD për pranimin e draft Raportit të Auditimit të PF 2011, i cili në bazë të shkresës të NJPMNP duhet të aprovohet nga Bordi.
BD theksoi se ky draft duhet të kaloj në Komision të Auditimit e pastaj në BD për aprovim.

## Lista e shkurtesave

ATR – Autotransformatori

ATC (Available Transfer Capacity) – Kapaciteti i disponueshëm

BK – Buxheti i Kosovës

BNJ – Burimet Njerëzore

ECLO – ( nga angl. European Commission Liaison Office) - Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

ENTSO E - (European Network of Transmission System Operators for Electricity)- Rrjeti Evropian

i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike

GjQ – Gjykata e Qarkut

IKP – Indikatorët Kyç të Performancës

KA – Konflikt Administrativ

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

KfW- Banka Gjermane për Zhvillim

KOSTT- Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu

LP – Largpërçuesi

NEF (Net Export Flow) – Eksporti i Kosovës

NIF - (Net Import Flow) – Importi neto për nevojat e Kosovës

NS - Nënstacioni

NP – Ndërmarrjet publike

NJPMNP – Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

OST – Operator i Sistemit të Transmisionit

PpE - Propozim për Ekzekutim

SCADA /EMS- (System Control and Data Acquisition/Energy Managament System)-Sistemi i

kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave/Sistemi i manaxhimit të energjisë

TP – Tatimi në pronë

ZRrE – Zyra e Rregullatorit të Energjisë